

Shtegu i luleve

MK32-12-114-SO-D



Ky botim është redaktuar nga Drejtoria Gjenerale e Ambientit Jetësor.

Botimi është në dispozicion edhe në ueb faqen e DG për të Rinj dhe Ambient Jetësor:
http://ec.europa.eu/environment/youth/index_en.html

Dorëshkrimi: Benua Kope
Ilustrimet: Nikola Vio
Produksioni teknik: Rrjeti Shërbyes Evropian

**Europa Direkt është shërbim që ju ndihmon të gjeni përgjigje
në pyetjet tuaja mbi Bashkimin Evropian**

**Numri i telefonit pa pagesë (*):
00 800 6 7 8 9 10 11**

(*) Disa operatorë të telefonisë mobile nuk lejojnë qasje në numra që fillojnë me 00 800 ose këto thirrje mund të fakturohen.

Një numër i madh i informatave plotësuese mbi Bashkimin Evropian, janë në dispozicion në Internet.
Këto mund t'i gjeni përmes serverit Europa (<http://ec.europa.eu>).

Të dhënat e katalogimit mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra e Botimeve Zyrtare të Komuniteteve Evropiane, 2009

ISBN 978-92-9238-065-6
doi 10.2871/26294

© Komunitetet Evropiane, 2009
Reprodukimi është i autorizuar vetëm me kusht që burimi i reprodukimit të jetë i njohur.

Shtypur në ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Tomi ishte i lumtur. Flori – shoqja e tij që jeton në Ishullin e Kaltër – më në fund erdhi ta vizitojë në Qytetin Merlin. Ajo arriti dje në mëngjes. Sot moti ishte gri dhe i ftohtë. Nuk kishte aspak rreze dielli siç është mësuar Flori në shtëpi!

“Asnjëherë nuk e imagjinoja qytetin tënd kështu” tha Flori.
“Sa erë të keqe që mban!” Ajo kishte lidhur një shami portokalle rreth fytyrës sepse i pengonte tymi i trafikut.

Tomi u ngrys.

“Më vjen keq”, tha ai. “Kjo pjesë e qytetit quhet Rruga Hasëll. Këtu ka gjithnjë shumë makina ...



Në mes të rrugës Hasëll trafiku ishte bllokuar. Shoferët ia prenin rrugën njëri-tjetrit dhe i binin borisë me padurim. Tyt tyyyt! Bip biiiii! Flori i mbylli veshët. Asnjëherë nuk kishte dëgjuar zhurmë të këtillë!

Pak më vonë vuri re që në anën e kundërt të rrugës kishte një park dhe menjëherë përtej gardhit ishte dhelpra Lila.

“Shiko, Tom! Ja ku është Lila me këlyshat e saj! Eja t’i shohim!” tha Flori, dhe filloi ta kalojë rrugën.

Tom i kapi për dore.

“Ndalo!” i tha. “Këtu është rrezik ta kalosh rrugën. Duhet të kalojmë te kalimi i këmbësorëve!”

Në atë çast, u dëgjua një kërcëllimë e gomave dhe një makinë e kuqe sportive doli nga radha. Ishte z. Rejs, shoferi më i padurimshëm. Ai mundohet të tejkalonte gjithkë tjetër, duke vozitur në trotuar! Pjesa anësore e makinës preku krahun e Florit dhe pasqyra e krahut ia grisi mëngun. Flori u rrëxua në trotuar.



Tomi vuri re se Flori u lëndua. Supi i saj ishte gjakosur, duke lënë njollë në fustanin e saj të bardhë. Ajo rrinte shtrirë, me sy të mbyllur. Z. Rejs doli nga makina. Ai dukej i merakosur.

“O zot, çfarë bëra!” tha ai. “A të thërras ambulancën?”

“Nuk do të depërtojë nga trafiku” tha Tomi. Ai u përkul dhe goditi faqen e Florit. Ajo i hapi sytë.

“Mos u mërzit”, tha Tomi. “Do të thërras ndihmë”.

Lila dhe këlyshët e saj erdhën me vrap.

“Lila” tha Tomi, “shko gjeje zonjën Dejvis, infermieren e ambulantës - është menjëherë përtej parkut. Unë do ta thërras mikun tonë z. Dikson nga stacioni i policisë te kthesa”.

Z. Rejs mbante kokën me duar. Ai përsëriste
“Oh çfarë bëra? Oh çfarë bëra?”

Flori u mundua të ngrihet por Tomi nuk e la.

“Më së miri është të mos lëvizësh”, tha ai. “Rri aty ku je”.

Katër këlyshat e dhelpres nuhasnin kokën e Florit, sikur donin të bëheshin jastëk i butë për Florin.

Tomi ia shtrëngoi dorën Florit. “Mos ki gjalle”, i tha ai, “ja ku po vjen infermierja”.





Ndërkohë, trafiku në Rrugën Hasëll po bllokohej akoma më shumë dhe makinat u binin borive pa pushim. Disa shoferë i kishin hapur dritaret dhe po i bërtisnin njëri-tjetrit.

“Hej, ç’po ndodh?” “Mos ma blloko rrugën!” “Do të vonohem!” Z. Rejs vazhdonte të përsërisë “Mjeri unë çfarë bëra? Oh, çfarë bëra unë?”

Gjithçka ishte e kotë dhe e zemëronte Tomin.

“Flor”, tha ai, “Nuk mund të të lë vetëm këtu. Dikush duhet të shkojë në stacionin e policisë!”

Goldi, këlyshi më i madh i dhelprës Lila, kërceu dhe i lëpiu dorën e Tomit.

“E kuptova!” tha Tomi duke buzëqeshur. “Ti don ta thërrasësh z. Dikson? Mirë atëhere, shko!” Goldi u nis me shpejtësinë që mund ta mbanin këmbët.

Flori rënkoi.

“A të dhemb shumë?” pyeti Tomi me merak.

Flori shtrëngoi dhëmbët dhe tundi kokën. Mirëpo Tomi vuri re se njolla e kuqe në fustanin e saj po bëhej më e madhe. Ai paloi facoletën e Florit dhe e shtrëngoi fortë plagën në supin e saj.

Nuk kaloi shumë kohë dhe ia mbërriu polici, së bashku me Goldin që ecte shpejtë pranë tij.

“Çfarë është kjo?” pyeti ai – dhe Tomi sqaroi.

Z. Dikson tha se do të bisedonte me z. Rejs pasi të rregullonte trafikun e bllokuar.

Një nga shoferët po i jepte superxhiro motorit të makinës. Bruuum! Bruum! Bruuum!

Z. Dikson shkoi dhe i tha:

“Qetësohuni zotëri! Kjo nuk do të ndihmojë. Kjo vetëm e ndot ajrin dhe bën ngrohjen e klimës më të shpejtë. Jam i bindur që nuk dëshironi të vështirësoni edhe më shumë një gjë që tani më është e vështirë ...”

Pastaj polici filloi të çbllokojë trafikun duke e drejtuar atë.

Z. Rejs ishte ulur në makinën e tij, akoma duke tundur kokën dhe thoshte “Un i mjeri çfarë bëra? Oh, çfarë bëra un i mjeri?!” Kjo po e bezdiste Tomin. Ai i thërriti z. Rejs:

“Në vend se të rrish ulur dhe të ofkëllosh, shko dhe sqaroju atyre shoferëve se ndotja e ajrit është duke e ngrohur planetin tonë!”



"Ke të drejtë," tha z. Rejs. "Duhet të bëj diçka të dobishme".

Ai shkoi te një makinë e kaltër e cila po bënte superxhiro. Vozitësja e makinës ishte mamaja e Lusi, dhe Lusi ishte brenda në makinë.


"Dëgjo", tha z. Rejs, "A e din se sa herë që i bën superxhiro makinës prodhon gazra shkarkues dhe shton ngrohjen globale? Nuk është mirë të jeni e padurimshme!"

Tomi buzëqeshte. Pastaj Lusi doli nga makina, kurse në dorë kishte çellon e saj. Ishte shumë e zemëruar.

"Mirë atëhere, unë do eci për të arritur në orën e muzikës!" tha ajo. Është më shpejtë dhe më mirë për ambientin jetësor. Pse të vozisësh deri aty ku mund të ecësh në këmbë?"

Makinat që vinin pas saj filluan përsëri t'u bien borive. Lusi u kthye dhe iu bërtiti:

"Pse po i bini borisë? Sepse ka trafik? Ju jeni trafiku! Po i bëni potere vetes more teveqela!"



Me çellon në dorë, Lusi filloi të ecte drejt shkollës së muzikës. Mamaja e saj i thërriste:

“Kthehu Lusi! Hyp në makinë!”

“Jo!” u përgjigj Lusi. “Kjo është hera e fundit të shkoj në shkollë të muzikës me makinë! Shkolla nuk është larg nga shtëpia, dhe të gjithë shokët e mi ecin deri atje. Është më interesant se edhe mund të bisedojmë gjatë rrugës. Veç kësaj, ecja është e shëndetshme!”

Kështu, Lusi vazhdoi të ecë, me vendosmëri.



Mu atëherë, Lila u kthye me zonjën Dejvis, infermierën. Ato ishin të shoqëruara nga vet Kryetari i komunës së Qytetit Merlin!

Zonja Dejvis u ul në gjunjë afër Florit dhe me kujdes zërtheu fustanin e grisur dhe të njollosur. Kryetari i komunës shikonte me shqetësim, kurse Flori ia kishte shtrënguar fortë dorën Tomit.

Zonja Dejvis buzëqeshi.

“Nuk është prerje e thellë, shpirt i vogël. Do ta dezinfektoj do të vë një fashë dhe për disa ditë do të bëhesh fil!”

“Oh!” tha Kryetari i komunës. “Çfarë lehtësimi! Zonjusha Flori, më vjen shumë keq që përjetuat një gjë të tillë në vizitën tuaj të parë në qytetin tonë”.

Tomi u ngrit dhe shikoi se si z. Dikson akoma mundohej të drejtonte trafikun e bllokuar.

“Duhet të ndryshojmë diçka në rrugën Hasëll zotëri Kryetar” tha Tomi. “Shumë është e zhurmshme, shumë e rrezikshme, shumë e ndotur, shumë...”

“Ke të drejtë Tom!” tha Kryetari i komunës. “Pas kësaj që i ndodhi Florit sot, nuk mund të lejoj të vazhdojë kështu. Ndoshta duhet të vendosi të ... Po! E gjeta! Vendosa ta mbylli rrugën Hasëll për trafik!”

Flori i buzëqeshi Kryetarit të komunës dhe tha “Është vendim i mirë!”.



Kryetari i Komunës nuk humbi kohë dhe për një kohë të shkurtër rruga Hasëll u transformua plotësisht. Një ditë të bukur, Kryetari i komunës i ftoi të gjithë në ceremoninë e hapjes dhe mbajti fjalim.

“Bashkëqytetarë të mi të nderuar,” tha ai: “Sot, kam nderin të inauguroj zonën e re të këmbësorëve në Qytetin Merlin”.

(Kryetari i komunës e ka shprehur të përdorë fjalë të gjata!)

“Natyrshëm se, të gjithë neve na duhen makina dhe automjete të tjera rrugore. Mirëpo, na duhen edhe vende të qeta, të sigurt dhe pa trafik ku ajri është i pastër dhe ku mund të bëjmë shopping dhe të takojmë miqtë pa ... pa bezdi. Na duhen vende si ky!”

“Pra, sot dua të falemnderoj dy njerëz ...”

“Së pari z. Rejs. Ai propozoi të krijohet një zonë ku fëmijët e Qytetit Merlin do të mësojnë se si të shfrytëzojnë rrugët pa rrezik dhe të mos jenë të rrethuar nga trafiku”.

Të gjithë duartrokitën dhe z. Rejs dukej i kënaqur.

“Dhe së dyti, falënderojmë mikeshën tonë Florin, aksidenti i të cilës ishte arsya e fillimit të këtij projekti.

Jemi shumë të lumtur që ajo është prezente në këtë ditë të veçantë”. Të gjithë duartrokitën sërisht.

“Flori”, tha Kryetari i komunës: “emri yt do të thotë lule ose blerim. Prandaj, rruga e re do të mbajë emrin ... Shtegu i Blertë!”



Njerëzit duartrokisnin dhe brohorisnin zëshëm. Atëherë, Kryetari i komunës i luti të gjithë të dëgjojnë me vëmendje. U dëgjua një tingull i bukur i një kënge në çello. Ishte Lusi! Sa bukur që luante në çello! Ishte ide shumë e mirë që e ftuan të performonte gjatë ceremonisë së hapjes! Në afërsi, disa fëmijë po ngisnin bicikletat, triçiklat dhe motoçikletat e tyre përbrenda qarkut të sigurtë të rrugës. Si mendoni, kush ishte duke i parë këta fëmijë me buzë në gaz? Natyrisht që z. Rejs.

Flori iu afrua t'i fliste. "Tungjatjeta, z. Rejs", tha ajo. "Ideja jote ishte shumë e mirë. Falemnderit!"

"Ishte mënyra ime për të kërkuar falje për... atë që të ndodhi ty", tha z. Rejs. "Si je tani Flori?"

"Më mirë", tha Flori. "Siç tha edhe zonja Dejvis, u bëra fil!" Dhe të dy qeshën së bashku.



Tomi iu afrua Florit.

“Shiko”, tha ai: “E di se duhet të shkosh në shtëpi nesër. Prandaj dua... vetëm desha të ta jap këtë, si kujtim nga Shtegu i Blertë dhe Qyteti Merlin”. Dhe ia ofroi asaj lulen e bukur.

“Desha të them edhe ...” Tomi u skuq i turpëruar dhe i pëshpëriti diçka në vesh Florit. Ne nuk e dimë se çfarë i tha por mund të supozojmë.

“Edhe unë Tom”, tha Flori. Në të njëjtin çast, një zog ia tha këngës së vet të ëmbël në Shtegun e Blertë.

“Nesër do të vi me ty në këmbë deri në liman. Atje të pret anija e cila do të të kthejë në Ishullin e Kaltër. Gjatë rrugës drejt limanit mund të flasim për ndodhirat e vizitës tënde në Qytetin Merlin. Kemi shumë për të thënë!”

Kontaktimi me BE-në



ONLAJN

Informata në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian mund të gjeni në ueb faqen Europa: europa.eu



PERSONALISHT

Në mbarë Evropën ka qindra qendra lokale informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në ueb faqen Europe Direct: europedirect.europa.eu



PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS

Europe Direct është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja lidhur me Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6 7 8 9 10 11**, telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së +32 2 299 96 96 ose me anë të postës elektronike të ueb faqes Europe Direct: europedirect.europa.eu



LEXONI MBI EVROPËN

Për të lëxuar botimet mbi BE-në, vetëm duhet të klikoni një herë në ueb faqen e librisë të BE-së: bookshop.europa.eu

Delegacioni i Bashkimit Evropian

M.H. Jasmin 52v
1000 Shkup
Tel. 02/3248 500
Faks. 02/3248 501
Internet: www.delmkd.ec.europa.eu
E-mail: Delegation-FYRMacedonia@ec.europa.eu

Qendra Informative e Bashkimit Evropian

M.H. Jasmin 52v
1000 Shkup
Tel/faks. 02/3296-363
Internet: www.euic.mk
E-mail: euinfo@euic.mk

Qendra Informative e BE-së, Manastir

Bul. "1 Maji" 61
7000 Manastir
Tel. 047 298 336
E-mail: bitola@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Veles

Rr. "Panko Brashnar" 1
1400 Veles
Tel. 043 232 406
E-mail: veles@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Gostivar

Bul. "Braça Ginovski" 61
1230 Gostivar
Tel. 042 218 167
E-mail: gostivar@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Kavadarci

Rr. "Marshal Tito" bb
1430 Kavadarci
Tel. 043 400 217
E-mail: kavadarci@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Koçani

Rr. "Rade Kratoçev" 1
2300 Koçani
Tel. 033 274 001
E-mail: kocani@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Kumanovë

Sheshi "Jugosllavia e re" bb
1300 Kumanovë
Tel. 031 438 663
E-mail: kumanovo@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Tetovë

Rr. "Dervish Cara" bb
1200 Tetovë
Tel. 044 343 646
E-mail: tetovo@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Gjevgjeli

Rr. "Dimitar Vllahov" 4
1480 Gjevgjeli
Tel. 034 213 843
E-mail: gevgelija@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Ohër

Rr. "Dimitar Vllahov" 57
6000 Ohër
Tel. 046 230 175
E-mail: ohrid@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Dibër

Rr. "8 Shtatori" bb
1250 Dibër
Tel. 046 831 196
E-mail: debar@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Strumicë

Rr. "Blagoj Muçeto" 26
2400 Strumicë

Tel. 034 349 040
E-mail: strumica@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së, Kriva Pallankë

Rr. "Shën Joakim Osogovski" 175
1330 Kriva Pallankë
Tel. 031 375 035
E-mail: krivapalanka@euinfopoint.mk

Qendra Informative e BE-së në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski"

Bul. "Goce Delçev" 6
1000 Shkup
Tel. 02 3115 177
E-mail: nul@euinfopoint.mk

EUJ – Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi";

Fakulteti Ekonomik, Shkup
Bul. "Krstev Misirkov" bb
1000 Shkup
Tel. 02 3286 835
E-mail: eui-sk@eccf.ukim.edu.mk

EUJ – Universiteti "Shën Kliment Ohridski";

Fakulteti për Menaxhim dhe Administrim të Sistemeve Informative, Manastir
Rr. "Partizanska" bb
7000 Manastir
Tel. 047 259 923
E-mail: eui-bt@famis.edu.mk

EUJ – Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

Rr. "Iliindenska" bb
1200 Tetovë
Tel. 044 356 316
E-mail: eui-tes@seeu.edu.mk

Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian ka përfaqësi të Komisionit dhe zyra e përfaqësi të Parlamentit Evropian. Komisioni Evropian ka gjithashtu edhe delegacione në vende të tjera të botës.

Kopje të këtij botimi janë në dispozicion pa pagesë, në:

Komisionin Evropian
Drejtoria-Gjenerale e Ambientit Jetësor
Qendra Informative (BU-9 0/11)
B-1049 Bruksel

<http://bookshop.eu/>

Komisioni Evropian

Shtegu i Blertë

Lluksemburg: Zyra e Botimeve
Zyrtare të Komuniteteve Evropiane

2009 – 20 fq. – 16.2 x 22.9 cm

ISBN 978-92-9238-065-6
doi 10.2871/26294